



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:191253
Datë: 27.02.2024
Numri i dokumentit: 05381041

KPPP.nr.1431/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “DLD Group” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me adresë në Pejton rruga “Perandori Justinian” Nr.25, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.H. avokat nga Fushë Kosova, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.608/2023 të datës 24.08.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 08.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr.608/23 i datës 24.08.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan Kërçagu, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “DLD Group” Sh.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.608/23 të datës 24.08.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm faturës Nr.2022/0001 të datës 28.01.2022, duke detyruar debitorin që në emër të borxhit që rrjedh nga fatura e lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,875.00 Euro, me kamatë prej 8% sipas LMD-së që nga data e paraqitjes së propozimit për përmbartim e deri në ditën e ekzekutimit të pagesës, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, për shkak të cenimit qenësor të rregullave të procedurës përbarimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ka theksuar se urdhri për përbarim i lëshuar nga Përbaruesi Privat është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, për faktin se e njejta faturë me nr.2022/0001 e datës 28.01.2022 në vlerë prej 1,875.00 Euro është paguar nga ana e debitorit. Ka theksuar se së bashku me prapësim ka bashkangjitur raportin e listës së Kuponit të shpenzimeve. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të abrogohet urdhri për përbarim i Përbaruesit Privat.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura nr.2022/0001 e datës 28.01.2022, në bazë të së cilës është lejuar përbarimi, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është dorëzuar dhe është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, ngase në këtë faturë është evidentuar vetëm nënshkrimi i debitorit ndërsa mungon vula e pranimit të debitorit.

Gjykata konstatoi se në rastin konkret, përkundër faktit se fatura e lartcekur përmban një nënshkrim tek pranuesi i faturave, megjithatë pa vulën e pranimit të debitorit për gjykatën nuk është e mjaftueshme për të identifikuar se a është bërë dorëzimi i rregullt i faturës lëndore tek debitori-Komuna e Prishtinës, në mënyrë që debitori të njoftohet me detyrimin që buron nga e njejta.

Gjykata vlerëson se meqenëse kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë nga e cila rezulton se pranimi i faturës është bërë në mënyrë të rregullt nga debitori, atëherë rezulton se fatura e lartcekur nuk mund të paraqes bazë për lejimin e përmbarimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1431/23 me datë 08.02.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.